



Pranuar / Dostignat Prilapen / Pristato Received / Delivered	12.05.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org. Unit	SKPM/BIJK	2730/2022	114



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.248/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Avdyl Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.248/2022 të datës 17.03.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë kundër Vendimit me Nr. 255/2022 të datës 21.02.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

Përfundim Procedimi administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.248/2022 të datës 17.03.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, më datë 15.11.2021 ka shpallur konkursin për pozitën Udhëheqës i Sektorit të Shkrimore në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, në të cilin konkurs ka aplikuar dhe ankuesi, i cili është përfshirë në fazat e rekrutimit. Më datës 29.12.2021 është publikuar njoftimin për përzgjedhje përfundimtare në bazë të të cilit ankuesi nuk ka rezultuar si kandidat i suksesshëm.

Më datë 24.01.2022 ankuesi ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës më datë 21.02.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. 255/2022 me të cilin ka

refuzuar ankesën e ankuesit duke e lënë në fuqi njoftimin e datës 29.12.2021 për kandidatin e suksesshëm.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr. 255/2022 të datës 21.02.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, përmes postës më datë 15.03.2022 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila më datë 17.03.2022 është pranuar dhe është regjistruar me numër të ankesës A.nr.248/2022 dhe Nr. Port:1423/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 23.03.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Këshilli, më datë 04.04.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.04.2022 ka nxjerr Vendim VK.nr.34/2022 me të cilin ka vazhduar afatin për vendosje edhe për 10 ditë punë për rastin e ankuesit, pas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për shkak të specifikave të ankesës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot:1423/2022 të datës 17.03.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Zarin e datës 15.03.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 23.03.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 04.04.2022; Vendimin me Nr. 255/2022 të datës 21.02.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Ankesën e datës 24.01.2022 të ankuesit; Procesverbal i shqyrtimit të ankesës; Njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare i datës 29.12.2021; Emailin e datës 16.12.2021; Regjistrimin e aplikacioneve të pranuar; Listën përfundimtare e përzgjedhjes së listës së ngushtë e datës 15.12.2021; Përmbledhjen e vlerësimeve individuale të listës së ngushtë e datës 15.12.2021; Vlerësimet individuale për listën e ngushtë datë 15.12.2021; Regjistri i njoftimin për ardhje në testin me shkrim i datës 16.12.2021; Regjistri i njoftimin për ardhje në intervistë; Deklaratë për mosekzistimin e konfliktit të interesave datës 15.12.2021; Renditja përfundimtare e kandidatëve; Formularin e vlerësimit individual në intervistë me gojë; Vlerësimi individual përfundimtar të kandidatëve për vendin e punë për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj datë 23.12.2021; Listën përfundimtare e përzgjedhjes të testit me shkrim e datës 20.12.2021; Përmbledhja e vlerësimeve individuale e testit me shkrim datë 20.12.2021; Konkursin për Udhëheqës të Sektorit të Shkrimores për Prokurorinë Themelore në Gjakovës; Vazhdim i konkursi i datës 01.12.2021; Vendimin e datës 14.12.2021 për themelimin e komisionit përzgjedhës të shërbimit civil; Testin me shkrim i datës 20.12.2021; Aplikacionin për punësim të kandidatit së bashku më dëshmitë e bashkangjitura; Aplikacionin për punësim të kandidatit së bashku më dëshmitë e bashkangjitura; Aplikacionin për punësim të kandidatit së bashku më dëshmitë e bashkangjitura; Aplikacionin për punësim të kandidatit së bashku më



dëshmitë e bashkangjitura; Aplikacionin për punësim të kandidatit së bashku më dëshmitë e bashkangjitura; Aplikacionin për punësim të kandidatit së bashku më dëshmitë e bashkangjitura; Vendimin VK.nr.34/2022 i datës 29.04.2022 i Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për procedimi administrativ të filluar me ankesën e ankuesit, **SEPSE:**

Ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 255/2022 të datës 21.02.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, pretendon se gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit për pozitën Udhëheqës i Sektorit të Shkrimore në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, ka pasur shkelje procedurale të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me këtë proces të rekrutimit ka pranuar edhe një ankesë nga një kandidat tjetër, ndërsa më datë 28.04.2022 ka vendosur për ankesën e kandidatit tjetër, ku ka nxjerr Vendim A.nr.236/2022 me të cilin ka aprovuar ankesën e datës 16.03.2022 të ankuesit duke e anuluar vendimin KA.Nr.9/2022 të datës 15.02.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Njoftimin përfundimtar të datës 29.12.2021 për pozitë Udhëheqës i Sektorit të Shkrimore në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, për shkak të shkeljeve procedurale në këtë procedurë, duke kthyer procesin në fazën fillestare të rekrutimit.

Bazuar në këtë, meqë pretendimet ankimore të ankuesit janë që ka pasur shkelje procedurale, dhe meqë ka kërkuar anulimin e kësaj procedure, dhe meqenëse me Vendimin A.nr.236/2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është anuluar kjo procedurë e rekrutimit duke kërkuar nga organi i punësimit që edhe njëherë të riprocedoj me procedurën e konkursit nga faza fillestare që përfshinë fazën e përpilimit të listës ë ngushtë e tutje, atëherë edhe pretendimet ankimore të ankuesit janë përmbushur, rrjedhimisht edhe objekti për të cilin kishte filluar procedimi administrativ më ankesën e ankuesit është bërë i pamundur, siç përcaktohet me dispozitat e nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë"*.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe sipas nenit 104 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.248/2022, datë 12/05/2022

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet;

- ❖ Ankuesit
- ❖ Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe;
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së;

